

NJOFTIM PUNE

ACREM është pjesë e **BALFIN Group** e specializuar në ofrimin e menaxhimit të pasurive të paluajtshme. **ACREM** është kompania menaxhuuese e Qendrave tregtare **TEG** dhe **QTU**, si dhe **TLP**, **Rolling Hills**, dhe **Ambasador 3**. Me një rrjet profesionistësh **ACREM**, ofron një paketë të gjërë shërbimesh si: Konsulencë Financiare, Marketing, Qiradhënie dhe Administrim.

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi **BALFIN** është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Zvicër, Kroaci dhe Holandë, me afërsisht 5,200 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit **BALFIN** përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me shumicë dhe pakicë, sistemin bankar, menaxhimin e aseteve, mediat dhe logjistikën. Grupi **BALFIN** po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Pozicioni: Teknik Elektrik
Departamenti: Mirëmbajtje Teknike
Vendndodhja: TEG

Përshkrim i Pozicionit të Punës

Tekniku Elektrik në Departamentin e Mirëmbajtjes Teknike në Qendër Tregtare është përgjegjës për kontrollin e sistemeve elektrike si dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Raporton tek Supervizori i turnit dhe Menaxheri i Departamentit për gjëndjen teknike të sistemeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Është përgjegjës për sistemet elektrike që përfshijnë panelet kryesore të tensionit të ulët dhe të mesëm.
2. Kontrollon gjëndjen e gjeneratorëve, gjëndjen e depozitës së naftës, panelet përkatëse.
3. Inspekton dhomën e paisjeve elektrike/elektronike dhe panelet për ndonjë anomali
4. Kontrollon llambat dhe transformatorët e llambave dhe bën zëvendësimin e tyre.
5. Është përgjegjës për matjen dhe kontrollin e parametrave elektrike në panelet kryesore dhe dytësore të shpërndarjes dhe njofton në mënyrë periodike për ecurinë e tyre.
6. Kontrollon sistemin për fikjen e zjarrit, sistemin sprinkler, alarmin kundra vjedhjes dhe njofton supervizorin nëse është e nevojshme.
7. Kontrollon dhe drejton pjesët elektrike & elektronike të komandimit të sistemeve BMS, sistemit të zjarrit, sistemit të telefonisë, sistemit kundër-vjedhjes, pompat e sistemit sprinkler/hidrant, panelet e komandimit të sistemit HVAC & ventilimit, sistemit CCTV dhe sistemit elektrik.
8. Kontrollon sistemin UPS nëse funksionon në rregull.

9. Eshtë përgjegjës për gjithë punët elektrike / elektronike në qendër dhe dyqanet e tjera të kontraktuara nën përgjegjësinë e Departamentit të Mirëmbajtjes Teknike dhe njofton supervizorin për gjërat e nevojshme.
10. Drejton sistemin e ndezjes / fikjes së gjithë dritave të qendrës në bazë të orarit të përcaktuar.
11. Kontrollon aparaturat nëse punojnë dhe ndizen në kohë nëpërmjet kontrollit me sistemin BMS & Timer.
12. Performon detyra të tjera të caktuara nga Supervizorët dhe Menaxheri i Departamentit.

Kërkesat e pozicionit të punës:

- Dimplomë Bachelor në Profilin Elektrik;
- Preferohet shkolle profesionale ose kurse profesionale për Teknike Elektrike/Elektronike.
- 2-3 vite punë në të njëjtin profil

Aftësi personale:

- Të ketë aftësi të mira të etikës dhe komunikimit;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të bashkëpunimit në grup;
- Të jetë person energjik dhe me vetëmotivim të lartë në punë;
- Të ketë aftësi shumë të mira ndërpersonale.

Kushtet e Punës: BALFIN Group ofron një paketë tërheqëse përfitimesh, duke përfshirë një shpërblim të drejtë në vlerësimin e meritës dhe performancës

Mënyra e aplikimit*:

Për të aplikuar për këtë pozicion, ju lutem dorëzoni CV nëpërmjet njëres nga mënyrat si në vijim:

1. Me e-mail: hr@acrem.al
2. Duke dërguar me postë ose aplikim i drejtëpërdrejtë në adresën e mëposhtme:
"Qendra Tregtare TEG, Rruga Nationale Tiranë-Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë, Shqipëri"

Afati i dorëzimit: deri në dt. **30/04/2023**

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*